

dhënë shpirt në rrugë. Në mbrëmje të së njëjtës ditë dhe me ndihmën e disa komshinjve, djemtë e Sakipit, Mehmeti dhe Arsimi, e varrosën të atin në oborrin e shtëpisë së Fadilit. Pasi e siguruan lejen e pushtetit serb, familjarët e kanë rivarrosur Sakipin në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, 3.08.1998.

Burimet: deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata K.B, FDH-35419; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Muharrem (Mehmet) Kadiri

(5.03.1943, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, mekanik, katër fëmijë)

Mehmet (Hafir) Kadiri

(4.09.1962, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Halit (Sadedin) Hoxha

(13.12.1972, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, student)

Ditën e shtunë, më 18.07.1998, Haliti e ka çuar të ëmën në Astrazup/Ostrozub [Malishevë/Mališevo]. Ditën tjetër, më 19.07.1998, u nis në shtëpi. Te vendi i quajtur *Carevëc/Carevac* u takua me Mehmetin dhe Muharremin, të cilët nga Dragobili/Dragobilj [Malishevë/Mališevo], ku ishin strehuar më parë, po shkonin t'i kontrollonin shtëpitë e veta në qytet. Që të tre jetonin në lagjen të ambulanca e qytetit [Rahovec/Orahovac]. Kur arritën në lagjen e vet, u strehuan në bodrum te Refki Mullaabazi, ku ishin edhe shumë refugjatë të tjerë. Në mbrëmje, Muharremi, Mehmeti dhe Haliti dolën për tu furnizuar me qirinj, sepse në qytet nuk kishte rrymë elektrike. Në afërsi të vendit të quajtur *Te Rrasat/Ploče*, që gjendet përmbi qytetin e **Rahovecit/Orahovac**, në rrugë për në Dragobil/Dragobilj, dikush ka shtënë mbi ta duke i privuar nga jeta. Të nesërmen, herët në mëngjes, policia i ka marr trupat e tyre të pajetë dhe i ka varrosur në Prizren. I vëllai i Halitit ka dëgjuar në radio njoftimin e policisë serbe për vrasjen e tre ushtarëve të UÇK-së. Pas përfundimit të luftës, trupat e Halitit, Mehmetit dhe

Muharremit u zhvarrosën nga varrezat e Prizrenit/Prizren. Pas identifikimit, që të tre u rivarrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, më 18.07.1999.

Burimet: deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.N, FDH-879; deklarata A.K, FDH-12932; deklarata A.H, FDH-12933; deklarata A.H, FDH-15503; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Sabrije (Sylejman Haxhihamza)

Tara

(10.11.1917, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)

Sabrija e moshëthyer ka jetuar në bashkësi familjare me djalin Ademin dhe familjen e tij. Për shkak të moshës, lëvizte tepër pak dhe vetëm kohë pas kohe. Në datën 18.07.1998, familja e Ademit e ka braktisur Rahovecin/Orahovac, ndërkaq në shtëpi mbetën vetëm Ademi dhe Sabrija. Ditën tjetër, më 19.07.1998, Ademi shkoi në livadhin e vet në vendin e quajtur *Rimnik*, për të përgatitur një strehimore për vetën dhe të ëmën. Kur u nis për në shtëpi, rrugës e sipër, policia serbe ka shtënë mbi të. Ia arriti që t'i evitonte plumbat dhe të braktisej në drejtim të fshatit Drenoc/Drenovac. Për fatin e së ëmës nuk dinte asgjë për një kohë të gjatë. Ademi me familjarët e vetë u kthyen në qytet më 2.08.1998. Sabrija nuk ishte në shtëpi. Gjashtë ditë më vonë, vajza e Sabrijes, Zymrija, ka mësuar nga disa banorë se te vreshtat, në fushën e quajtur *Bllato [Rahovec/Orahovac]*, ishte zbuluar kufoma e një personi të moshuar. Ademi e njoftoi policinë, me të cilën pak më vonë shkuan atje. Menjëherë e ka identifikuar të ëmën. Ishte e ngulfatur me shaminë e saj. Po atë ditë, Ademi me axhën Asllanin dhe dajën Ramadanin e kanë varrosur Sabrijen në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata A.T, FDH-34331; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Elhami (Qamil) Tahiraga

(7.01.1962, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Destan (Salih) Sharku

(4.11.1955, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, katër fëmijë)